



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 39/2011
Prishtinë, më 15.11.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha - Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija dhe Visar Ymeri.

I ftuar: Besim Beqaj, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë: Frymëzim Iusfaj, Gëzim Baxhaku dhe Ramadan Sejdiu - MZHE; Agron Demi-GAP, Ukë Gashi- ZPRK, Haxhi Gashi USAID/Deloitte, Ardian Kryeziu- USAID/BEEP, Shqipe Arifaj – AKK dhe Sanije Berisha – OSBE.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe konsulentët e Komisionit Brikena Hoxha dhe Visar Gjakova..

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 09.11.2011;
3. Seancë dëgjimore lidhur me raportin e performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2010;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 09. 11. 2011

Procesverbali i mbledhjes së datës 09. 11. 2011 u miratua pa vërejtje.

3. Seancë dëgjimore lidhur me raportin e performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2010

Kryetari – Për këtë pikë të rendit të ditës, e kemi ftuar ministrin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj për të njoftuar lidhur me raportin e performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2010, ku përmes këtij raporti, Komisioni mund të informohet më saktë lidhur me bilancet, të arriturat dhe stagnimet e ndërmarrjeve publike. Më pas, fjalën ia dha ministrit Besim Beqaj.

Besim Beqaj, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik– Paraqiti raportin dhe fillimisht sqaroi se ai i vitit 2009 është shtyrë për shkak të krizës politike në atë vit, ndërsa shtoi se raporti që i është ofruar Komisionit përfshin edhe vitin 2010. Në vijim, duke iu referuar raportit për ndërmarrjet publike, Beqaj tha se gjatë hartimit të këtij raporti, Ministria është fokusuar në: performancën operative, financiare, qeverisjen e korporatave dhe perspektivën e tyre në të ardhmen. Duke folur për aktivitetet e Ministrisë ndaj ndërmarrjeve publike, ai tha se Ministria ka qenë mjaft e angazhuar, përkatësisht Njësia për ndërmarrje publike në kuadër të kësaj Ministrie. Lidhur me këtë, si çështje kryesore në të cilat kemi qenë të fokusuar janë: Përforcimi i raportit të rregullt, këshilla për drejtorët e ndërmarrjeve publike dhe sekretarët e korporatave, pjesëmarrja në takime të bordit të ndërmarrjeve publike, përgatitja dhe procedimi i pagesave të subvencioneve dhe granteve kapitale, përpilimi dhe shpërndarja e udhëzuesve për drejtorët e ndërmarrjeve, monitorimi i bordeve dhe rishikimi i përshtatjes me kërkesat ligjore. Duke folur për ndërmarrjet e mëdha publike, siç janë: PTK-ja, KEK-u dhe Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" i Prishtinës, Beqaj nënvizoi se kanë treguar performancë pozitive krahasuar me vitet paraprake. Ai me këtë rast, solli të dhëna tabelare mbi performancën e këtyre ndërmarrjeve.

Ministrit iu shtruan pyetje nga deputetët si: Myzeje Selmani, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Biserka Kostiq, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi dhe Fikrim Damka, si dhe nga Agron Demi nga Instituti GAP që ishte i ftuar në këtë seancë dëgjimore.

Pas debatit Komisioni unanimisht nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti i performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2010 dhe Kuvendi i parashtron këtë

R e k o m a n d i m

- 1. Të miratohet raporti i performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2010.*
- 2. Arsyetimin e raportit me rekomandime e paraqet kryetari i Komisionit, Zenun Pajaziti.*

Për këtë pikë të rendit të ditës, këtij procesverbali i është bashkëngjitur transkripti.

4. Të ndryshme

Kryetari – Njoftoi deputetët se do të organizohet një tryezë e rrumbullakët mbi legjislacionin për tregti me temën: “Legjislacioni për tregtinë që më së miri lehtëson tregtinë dhe nxitë prodhimin e brendshëm”. Tryeza do të mbahet më 12 dhjetor 2011, në mbështetje të projektit të USAID-BEEP. Ai gjithashtu njoftoi deputetët se nga data 18 - 20 nëntor, një delegacion i Komisionit do të jetë në Durrës në një punëtori që organizohet nga KFOS-i në lidhje me politikat e energjisë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Kryetari i Komisionit

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI
MBAJTUR MË 15.11.2011

TRANSKRIPT
SA SASTANKA KOMISIJE ZA PRIVREDNI RAZVOJ, INFRAASTRUKTURE,
INDUSTRIJU I TRGOVINU,
ODRŽANOG 15.11.2011. GODINE

NËNTOR- NOVEMBAR
2011

E martë, më 15.11.2011

Mbledhjen drejton: Zenun Pajaziti kryetar i Komisionit për zhvillim ekonomik, infrastrukture, tregti dhe industri.

KRYETARI: Faleminderit, shumë për pjesëmarrjen!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të komisionit,

I nderuar zoti ministër me bashkëpunëtorët. Faleminderit që iu keni përgjigjur ftesës të jeni sot në takimin tonë. Më lejoni që shpejt të kalojmë nëpër procedurat formale të mbledhjes së rregullt të komisionit tonë. Komisioni ka paraparë, siç e dini në mbledhjen e kaluar që sot ta kemi vetëm një pikë të rendit të ditës dhe atë Raportin e performancës të ndërmarrjeve publike për vitin 2010, një seancë dëgjimore. Formalisht më duhet të kërkoj aprovimin e rendit të ditës, nga ju. Kush është “për”? Faleminderit! Po ashtu rreth pikës së dytë, miratimit të procesverbalit nga mbledhja e datës 9, nëse ka dikush diçka, nëse jo e konsiderojmë si të aprovuar. Faleminderit!

Atëherë, kalojmë në pikën 3. Edhe njëherë po e përmendi që një prej çështjeve që ne i kemi trajtuar si komision kohëve të fundit ka qenë dhe kemi filluar ta trajtojmë funksionimin e ndërmarrjeve publike ose performancës të ndërmarrjeve publike. Siç, e dini ne po ashtu kemi marrë disa raporte, për disa agjencione të cilat Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri i monitoron. Kemi trajtuar po ashtu, përveç raporteve të tyre edhe dokumente tjera dhe po ashtu kemi bë vizita të ndryshme, në ndërkohë që e kemi paraparë që ta kemi në trajtim performancën e ndërmarrjeve publike ose një raport të tërësishëm. Unë këtu e kam edhe një raport të ndërmarrjeve publike të zhvilluar nga një njësi përkatëse e ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Është hera e parë deri më tash që një raport i tillë ekziston dhe ka ardhur në Kuvend. Më lejoni të ju them po ashtu që në përgatitje të këtij takimi ne kemi pas kontaktet me një ministri, ka qenë njëfarë mënyre ideja që njësia përkatëse që ka punuar në hartimin e këtij raporti të jetë sot prezent me ne. Kam biseduar me ministrin dhe ka shprehë ministri gatishmërinë që edhe ai vetë për një pjesë të përgjithshme politike të funksionimit të këtyre ndërmarrjeve edhe të raportit të vijë këtu. Zoti ministër ju falënderoj për gatishmërinë se nuk është, jo që nuk është hera e parë, por kemi disa raste që ju personalisht keni ardhur për çështje të ndryshme të raportit me komision ose të prezantoni punën tuaj në komision. Është me rëndësi për ne po ashtu që të trajtohet kjo temë për faktin se kemi disa ligje që mbulojnë funksionimin e agjencioneve të ndryshme dhe për më tepër kanë proces edhe ndryshim, plotësim ndryshimet të disa prej ligjeve dhe po ashtu ka ide që të njëjtën kohë të shfrytëzohet koha që të harmonizohen në tërësi funksionimi i këtyre agjencioneve.

Për më tepër ju jeni pjesa e të cila merreni drejtpërdrejtë dhe më afër me këtë problematikë. Pa e harxhuar shumë kohën në këtë drejtim unë dëshiroj secili të ketë edhe pyetje nga ana e deputetëve, unë dëshiroj zoti ministër të ju jap juve fjalën dhe pastaj edhe përfaqësuesit nga agjencioni ose drejtuesit të ministrisë përkatëse që të prezantoni Raportin e performancës të ndërmarrjeve publike, për vitin 2010. Zoti ministër e keni fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit kryetar!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Unë me kënaqësi kam pranuar që të takohemi sot për të diskutuar mbi funksionimin dhe performancën e ndërmarrjeve publike në Republikën e Kosovës.

Para se të hyjë në një përshkrim të gjendjes çfarë e kemi në këto ndërmarrje, dëshiroj të theksoj se konform ristrukturimit institucional edhe qeveritar, ministria për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike ka kaluar nga ish-ministria e Financave dhe Ekonomisë në ministrinë për Zhvillim Ekonomik.

Kjo njësi merret vetëm me monitorim të ndërmarrjeve publike, performancën e tyre operative, financiare dhe me qeverisjen kooperative, çka do të thotë që nuk merret me menaxhim, nuk merret me operim të drejtpërdrejtë të menaxhimeve dhe operimin e ndërmarrjeve publike, pjesë e bordeve të cilat i udhëheqin këto ndërmarrje dhe drejtorëve ekzekutiv të tyre. Dëshirova që në fillim ta bëj të qartë se këtu kemi të bëjmë vetëm me monitorimin dhe monitorimi bëhet në dy forma, një është përmes auditorëve të jashtëm të cilët ata janë të thirrur për të bërë dhe kemi disa raste kur edhe auditori i përgjithshëm bën auditim të këtyre ndërmarrjeve dhe normalisht ne si njësi kohë pas kohe edhe bëjmë monitorimin e performancës ... kooperative. Konform Ligjit për ndërmarrjen publike është hera e parë që ne i ofrojmë Kuvendit një raport mbi performancën e ndërmarrjeve publike dhe ky raport përmban edhe vitin 2009 dhe vitin 2010.

Vitin 2009 për shkak se në kohën kur është dashur të dërgohet në Kuvend, Kuvendi është shpërbërë për shkak të krizës institucionale e cila ishte realisht e... si obligim për tu paraqitur në këtë legjislativ kësaj radhe ... pra, në raport do ta keni performancën e keni 2009, performancën e vitit 2010 dhe një orientim çfarë duhej të ishte në vitin 2011. Qysh e thash më herët, këto ndërmarrje publike janë të themeluara me ligj mbi ndërmarrjet, të cilat i ka dy lista të ndërmarrjeve publike, ndërmarrjet publike në nivel qendror dhe ato rajonal dhe ndërmarrjet në nivel lokal. Për ndërmarrjet në nivel qendror të cilën ngjashmërisht në mënyrë të drejtpërdrejtë monitorimi bëhet nga njësia jonë, aksionare ... e Republikës së Kosovës dhe aktiviteti qoftë edhe i subvencionimit, qoftë edhe i përkrahjes së këtyre institucionale shkon përmes njësisë së shërbimit ekonomik. Ndërsa, për ndërmarrjet lokale publike të cilat gjithashtu janë ... në mënyrë të drejtpërdrejtë aksionare janë komunat dhe kanë pothuajse të njëjtën përbërje sa i përket funksionimit të tyre ndërmarrjeve. Dëshiroj të theksoj se ne tani jemi në proces të amendamentimit të Ligjit për ndërmarrje publike dhe ky amendamentim do të sqaroj edhe më tutje disa gjëra, të cilat janë në hendikep dhe të cilat janë identifikuar gjatë monitorimit. Hendikepi që janë detyruar, do të thotë, kanë të bëjnë me natyrën e ndryshme qoftë prej planifikimeve, prej përcaktimit të strukturave të cilat nuk janë identike shumë në ndërmarrjet publike në nivel lokal dhe atë qendrorë deri në gatishmërinë e angazhimit komunal dhe dedikimin financiar të cilët mund ta kenë secila nga këto ndërmarrjet përmes angazhimit të Qeverisë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Performanca operative kryesisht merret, pra në raport e keni të performancën e partive që merren me rezultatet e arritura, efikasitetin dhe kualitetin e shërbimeve. Pjesa tjetër për performanca financiare e trajton e qarkullimin e arritur, efikasitetin e shpenzimeve dhe profitabilitetin e ndërmarrjeve dhe qeverisja kooperative, monitorimin e punës së bordeve, respektivisht llogaridhënia dhe planifikimi i biznesit. Në parim ndërmarrjet kanë performuar më mirë se sa në vitin paraprak, po flas tash në krahasim me vitin 2009 me vitin 2008, kemi një performancë të ngritur të tyre, sepse kemi një tendencë ku në disa ndërmarrje do të thotë ka investime më shumë në kapitalin në momente të caktuara ato janë paraqitur që ndoshta kanë më pak fitim të paraqitur, por kanë bërë investime më shumë kapitale dhe kjo ka rezultuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, por njëkohësisht kemi edhe një ulje të kostos në shumicën e ndërmarrjeve sa i përket gjatë kësaj periudhe.

Ne si ministri përpos që monitorimit i cili ka ardhur nga raporti i auditorëve, kemi bërë edhe monitorimin e performancës kooperative të ndërmarrjes, si me disa ekspertë nga të ndihmuar financisht nga Zvicra dhe realisht kemi parë atë që bordet rangohen në nivele të ndryshme dhe ato borde janë bërë nga bordet të cilat e kanë kryer misionin e tyre në plotëni, në bordet të cilat janë pozitive, por kanë çështje për të trajtuar dhe me bordet me të cilat duhet ta trajtojnë në mënyrë të metalizuar për funksionimin e këtyre ndërmarrjeve publike. Lidhur me aspektet individuale, të cilët te ndërmarrjet nuk do të ndalem. Kam me vete këtu drejtorin e njësisë për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike, por dëshiroj të theksoj që nëse flasim për

aspektet e ndërmarrjeve të mëdha, po e zëmë të KEK-u performanca është më e mirë se sa në vitin paraprak, pra është përmirësuar prodhimi i qymyrit për afër 2%, është përmirësuar energjia, do të thotë prodhimi i energjisë diku rreth 4%, po flas vitin 2010 në krahasim me vitin 2009. Inkasimi është përmirësuar për 11% apo realisht kemi inkasim të 87.9% të asaj çka faturohet atje në inkasim dhe kemi zvogëlim të humbjeve teknike dhe komerciale të energjisë për 1.22% duke u krahasuar me vitin 2009. Këto janë të dhëna që i keni edhe në raport ku është pjesa për secilën ndërmarrje veç e veç, në pjesët e para. Te kosti që është operatori i sistemit, do të thotë kemi zvogëlim të ndërprerjes në transimion në mënyrë të dukshme gati 3 herë, zvogëlim të humbjeve në transimion që është nga 174 GB sot kemi humbje në 131 GB, tek PTK-ja po flas me disa indikator të cilët janë të rëndësishëm dhe pastaj kur keni pyetje ne do të hyjmë edhe në detaje.

Tek PTK-ja kemi një rënie të fitimit në raport me vitin 2009, por duhet të shpjegojmë që rënia e fitimit nuk është rezultat i rënies së performancës së PTK-së, sepse kemi 11.4 milion euro të hyra më pak për shkak të kamatave të cilat i kanë paguar sa i kanë pas mjetet të cilat kanë qenë të padeklaruara si dividendë dhe njëkohësisht në vitin 2009 ata kanë marrë vendimin për reduktimin e tarifave që janë 50%. Kur ta shohim në total të hyrat janë më të mëdha se sa në vitin paraprak, por fitimi është më i vogël për shkak të këtyre elementeve të cilat i përmenda më herët. Tek numri i konsumatorëve, pra është rritur përmbi 23 000 konsumator në raport me vitin 2009 dhe ka rritje të shërbimeve në postë mbi dërgimin e pakove postare. Dëshiroj të ju informoj gjithashtu se dje Komiteti i Privatizimit për Post dhe Telekomin ka marrë vendim që konfrom vendimit paraprak kundraj kontaktit të postës të fillon edhe procedura për ndarjen ligjore të postës me çka do të posedohet menjëherë regjistrimi i ndërmarrjes përmes vendimit të Qeverisë dhe realisht ne në proces... si dy njësi të ndara. Dëshiroj të theksoj se është diskutuar shumë rreth blerjes së postës, asetet fizike të cilat janë relativisht të ndara janë komplet në pronësi të Postës së Kosovës.

Stabiliteti financiar i postës sigurohet përmes pagesës...fizike dhe ka pas shumë diskutime, debate të ndryshme mediatike që vlera e postës është kaq apo aq, po ju them që gjithë kur flasim për PTK-në, po ju them që gjithmonë ju referohemi aseteve fizike dhe asetet fizike nuk janë pjesë e procesit të privatizimit, sepse ato i mbeten Postës së Kosovës. Njëkohësisht, ne në këtë ndarje kemi marrë edhe një hap dhe ajo është që përveç qirasë një numër i shërbimeve të telekomit në të ardhmen duhet ta realizojë përmes postës, e cila i krijon hyrje diku rreth 8 milion euro në bazë vjetore, ndërsa shpenzimet operative të postës janë diku rreth 10 milion euro, gjë që realisht u jep edhe një arsye të stabilitetit, por njëkohësisht edhe të një performace të cilën duan ta ngritin në baza të rregullta.

Tek hekurudhat ne kemi proceduar në këtë vit, po ju them po ia bëj një uptade edhe vitit 2011, kemi proceduar me ndarje zyrtare konfrom rregullave të Bashkimit Evropian i kemi ndarë Treinkos dhe Infra Kos, pra atë që merret me infrastrukturë dhe atë që merret me operim të trenave. Ndarja është bërë funksionale, pra janë caktuar edhe bordet e përkohshme dhe realisht tani jemi në procesin e ndarjes së aseteve dhe ndarjen e obligimeve dhe shërbimeve të cilët ata do t'i ofrojnë. Në ndërkohë, kemi një rritje të numrit të udhëtarëve në transportin hekurudhor për 2 mijë udhëtare edhe pse ne edhe më tutje subvencionojmë, do të thotë Qeveria i subvencionon edhe më tutje udhëtimin e udhëtarëve me tren, ndërsa tek transportet kemi një rritje diku rreth përmbi 200 mijë ton që realisht tregon një orientim të ekonomisë tonë për shfrytëzim të hekurudhave.

Tek aeroporti performanca financiare është pozitive, ka rritje mbi 75 mijë pasagjerë ndaj vitit 2009 me vitin 2010 dhe ka rritje për atertime të aeroplanëve për 573. Normalisht tash kjo është në kompetencë të njësisë së partneritetit publiko privat pas ... të dhënies në partneritet publiko privat.

Tek ujësjellsat në përgjithësi nuk do të ndalemi në secilën veç e veç, por kemi një problem serioz e ai problem serioz është inkasimi i ujit të prodhuar. Neve kemi edhe humbje teknike të cilat janë për shkak të rrjetës së dobët, por kemi edhe humbje në inkasime, pra kemi probleme të theksuara. Këta e kemi problem në nivelin komunal, nëpër të gjitha komunat, por në nivele tjera vlen të theksohet se tash ministria për një kohë të gjatë, ministria e Shërbimit Ekonomik më herët ministria e Ekonomisë, i ka subvencionuar një numër të caktuar të qytetarëve, flitet fjala për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicë, pra njëkohësisht kemi edhe subvencionime të ujësjellseve gati pothuajse në të gjitha qytetet e Kosovës, sepse nuk ka pas mundësi.

Ndërmarrjet kanë përfunduar më mirë në krahasim me vitin 2009, pra kanë rritur inkasimin e tyre, por edhe më tutje niveli i inkasimit është në nivel jashtëzakonisht të... ne kemi bërë projekte më shumë mekanizma ndërkombëtar për ngritjen e performancës, udhëheqjen më të mirë të tyre dhe tash së voni kemi bërë edhe një marrëveshje me Qeverinë Gjermane për rregullimin edhe të ujit, por edhe sistemit të kanalizimit në Prizren që kap shifrën mbi 30 milion euro që veç do të merret në drejtim të përmirësimit të shërbimit për qytetarët në këtë komunë. Kjo është përafërsisht një përmbledhje e shkurtër për funksionimin e ndërmarrjeve. Ndërmarrjet kanë diku 14 463 të punësuar si total dhe që ne tani ... kemi hapur procesin e konkursit konform bazës ligjore për bordet e reja, bordet skadojnë kryesisht prej datës 16 deri më datën 23 dhjetor, konkursi është i hapur, konkursi është 30 ditë për të konkurruar dhe konkursi do të thotë është në nivel të trajtimit tash, në nivel të... për secilin bord veç e veç, pra janë diku rreth 16 ndërmarrje të cilat veç tash janë shpallur dhe shpjet do të trajtohen. Atë çka e tha kryetari është se ne tani do të shohim pas zgjedhjes së bordeve të reja një unifikim ...funksionimit të bordeve, pra vënien të një rregulli të detajlizuar për funksionim, po flas për nivelin e ndërmarrjeve qendrore, sepse për nivelin ... kjo nuk është kompetencë e drejtpërdrejtë e jona.

Unë e mirëpres të gjitha pyetjet e juaja për sqarime dhe normalisht aty ku ka nevojë për sqarime teknike do ta pyesim Ramadanin i cili është në mënyrë të drejtpërdrejtë i lidhur me këtë çështje. Faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit zoti ministër!

Nuk di nëse duhet të vë një pjesë të prezantimit edhe nga apo nëse e lëmë veç me pyetje, okej.

Unë kisha me hap debatin ose mundësinë e pyetjeve nga ana e deputetëve. Dëshiroj, të them po ashtu keni pas... falënderoj edhe shoqërinë civile e cila ka qenë aktive gjatë ... mbështetje në njëfarë mënyre në procesin e monitorimit të funksionimit të ndërmarrjeve publike. KIPRED me GAP si duket kanë bërë bashkë një monitorim të funksionimit të bordeve të ndërmarrjeve publike. Gjithsesi, çdo aktivitet i organizatave të ndryshme e shoqërisë civile në këtë drejtim i ndihmon procesit të konsolidimit edhe më të mirë. Këtu te ne besoj që prezenca e tyre këtu është sot e mirë. Ndërkohë që do të ketë pyetje të ndryshme unë kisha me thënë të ju jap fjalën deputetëve dhe në fund të përmbledhur, zoti ministër dhe po ashtu zoti Sejdiu nëse pyetjet janë më shumë ... do të mund të na ndihmonte në...

Ka disa, më lejoni vetëm t'i përmend disa prej çështjeve që unë mundohem ti identifikoj edhe nga raporti, por të cilat janë pjesë e interesimit edhe të deputetëve të cilat i kemi dëgjuar herë pas here në takimet tona. Përveç asaj që dimë për perspektivën e Qeverisë për funksionimet të cilat veç i tha ministri edhe me fillimin e procesit tash të bordeve të reja me konkurset e reja. Dëshirojmë, të dimë po ashtu se sa është e kënaqur njësia përkatëse që veç ministria me çështjen e raportimit, cili është përfaqësimi etnik dhe gjinor, është një çështje që po ashtu është shtruar edhe në komisionin tonë për këto agjencione, pastaj a ka marrë rekomandime apo masa për shërbimet janë marrë ndonjëherë ... me këto gjetjet e ndryshme etj, pavarësisht cilat kanë qenë... ky monitorim apo rezultat i auditimeve a është marrë ndonjë masë për përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve në formë rishtazi e kom fjalën. Pastaj, zbatimi i kodit etik në

ndërmarrje, a na zbatohet ky kod dhe kodi i etikës dhe i qeverisjes kooperative etj, këto janë disa prej çështjeve që veç unë i identifikova, por unë ju jap fjalën deputetëve që të nxjerrin, zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit kryetar! Përshëndetje për ministrin që ... Përshëndetje për përfaqësuesin e bordit dhe të gjitha mediat të cilat janë sot këtu me ne.

Duke u bazuar në Ligjin e ndërmarrjeve publike, ministri e potencoi se Ligji i ndërmarrjeve publike ka ardhur me pakon e presidentit Ahtisari, siç ka ardhur edhe Ligji për hekurudhat është shumë e rrugës që ministri në këtë takim na tregoi që ligji është në amandamentim për arsye se gjatë kalimit në mandatin e kaluar nuk kemi pas mundësi si komision parlamentar të bëjmë plotësim dhe ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike. Këta gjatë punës së tyre ekzekutivi ka vërejtur që ka mangësi është e vërtetë që ka mangësi ky ligj dhe është fatbardhësi që në këtë legjislacion deputetët e Kuvendit kanë mundësi të plotësojnë ndryshojnë ligjet që kanë ardhur me pakon e presidentit Ahtisari. Është hera e parë që vjen një raport për ndërmarrje publike, e potencoi edhe ministri për arsye se në mandatin e kaluar kur ka ardhur koha për të vjen raporti i performancave të ndërmarrjeve publike, Kuvendi veç është shpërndarë. Dhe, kjo jep mundësinë më të mirë me pa ku gjinden ndërmarrjet publike në Kosovë në bazë të Ligjit për ndërmarrje publike ku Qeveria në bazë të ligjit e ka njësinë për monitorim dhe përfaqësuesi apo zyrtari i lartë i njësisë për monitorim është sot këtu me neve.

Ministër unë kisha me shkuar vetëm në tri ndërmarrje publike, është çështja e KEK-ut, ju i potencuat të gjitha shifrat, unë s'kam nevojë mi potencuar, mirëpo prapëseprapë nuk është një performancë e mirë, 2009/2010 nuk është një performancë e mirë kur dihet se na kemi subvencione dhe ju e dini mjaftë mirë se na japim edhe kredi KEK-ut. Edhe një çështje tjetër të çështja e KEK-ut është ndarja e distribucionit dhe furnizimit dhe me sa më duket akoma është drejtori menaxhues i KEK-ut, në rast se s'gaboje edhe drejtori menaxhues i ... dhe furnizimit, ndërsa këtu pritet që ministri të shpall konkurs ndoshta për drejtorin e ri, për arsye se është në procesin e privatizimit dhe kish me qenë fatbardhësi që ky proces i privatizimit njëherë e përgjithmonë të përfundon ashtu si duhet. Ndërsa, te çështja e postës prej vendimit të mandatit të kaluar është marrë një vendim që projektet në Postë Telekomin e Kosovës të ndërpriten për arsye se Post Telekom i Kosovës është në fazën e privatizimit. Ju sot edhe nëpërmes mediave të shkruara kishit dhënë nga komiteti drejtues për privatizimin e Post Telekomit të Kosovës atë që e kemi kërkuar na si komision në mandatin e kaluar që mund të them se këtu duhet të japim një lëvdatë se e kemi kërkuar këtë ndarje dhe të shohim si po shkon procesi i privatizimit të Post Telekomit të Kosovës se është momenti i fundit që të hyjnë investimet e huaja në Post Telekomin e Kosovës.

Te KOST-i duhet të japim një meritë komisionit të mëparshëm parlamentar, i cili në punën edhe në Raportin e Progresit me Ligjin për energjinë dhe Ligjin për rregullatorin e energjisë i mundësoi KOST-it që të bënte një ndarje shumë të mirë me shtetin fqinjë Serb i cili na ka ngarkuar çdoherë me taksa më të larta për import të energjisë dhe aty është çështja që duhet të lëvdohet edhe ministri edhe drejtori i KOST-it për punën që është arritur atë ditë në të mirë të Kosovës.

Ndërsa, te Aeroporti i Prishtinës kisha me ta bërë një pyetje shumë të saktë, jeni kah e shihni si është kah realizohet kontrata e koncensionimit në mes të Aeroportit dhe Qeverisë së Kosovës? Dhe, cili është raporti juaj me njësinë e monitorimit me bordet të cilat i udhëheqin ndërmarrjet publike? Faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit zonja Selmani! Zoti Buzhala e ka kërkuar fjalën.

BERAT BUZHALA: ... mirëpo unë kisha dashur me u ndal edhe pak më shumë te KEK-u edhe te performanca e KEK-ut. Është përmendur një rritje, po mendoj në performancë, ishte nxjerrë një prodhim bruto... mirëpo, ajo që vërehet dhe është shenja më e keqe në këtë ... janë humbjet teknike dhe komerciale. Gjatë gjithë kësaj kohe, brenda një viti e kemi një zvogëlim të 1.20%. Sipas këtij trendi për me ardhur në suazat në një korporatë normale do të duhej që ky bord t'i kërkonte edhe 30 vjet kohë që me ardhur në 10% humbjet teknike dhe komerciale. Humbjet teknike siç dihet janë humbjet në rrjet, ndërsa humbjet komerciale janë vjedhjet të cilat nuk faturohen. Thënë me termat tjerë brenga ime është, e kemi 87% të rrymës së faturuar që inkasohet edhe i kemi 40% afër 89.5 që as nuk shihet, pra marrë në përgjegjësi prej rrymës që prodhohet në termocentrale dhe prej rrymës që Kosova e blen nga jashtë vetëm rreth 50% të saj inkasohet.

Pyetja jem lidhur me këtë tash është pas këtyre konstatimeve, sa ndikon kjo performancë e këtij bordi që ata pothuajse ta kanë të pamundur që të rizgjidhen apo të aplikojnë prapë, se e përmendi edhe ministri që do të jetë faza e konkursit ku të gjithë, a do të merren parasysh këto defekte kaq serioze që kryeshefi dhe anëtarët e tjerë të bordit, pothuajse ta kanë të pamundur që të aplikojnë apo ata mund edhe të aplikojnë, por që të merren parasysh si kandidatë seriozë për të ardhmen. Sepse përnjëmend ka kaluar një kohë e gjatë, ndërsa humbjet edhe vjedhjet që po bëhen në KEK, në vjedhjet kuptimin e rrymës se jo korrupsioni ajo nuk është çështje që është shtruar këtu, janë galoponte dhe do ta ndëshkonin rëndë secilin menaxher që pretendon ta udhëheqë një korporatë. Faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit zoti Buzhala! Zoti Zharku!

LUTFI ZHARKU: Faleminderit zoti kryetar! Zoti ministër, shumë shkurtë. Nga raporti shihet se e kemi vetëm një ndërmarrje fitimprurëse në Kosovë, ajo është PTK-ja dhe fatkeqësisht me një trend rënës, kështu që unë besoj se me procesin e privatizimit apo me partneritetin publiko-privat këto çështje do të zgjidhen. Ndërsa, te unë e kam një brengë për dy sektorët të cilat, sektorin e ujërave dhe mbeturinave të cilin aq shumë përkundër asaj që kemi një pasqyra për performancën e tyre financiare, por janë dy karakterizohen me dy çështje. Njëra është me një performancë shumë të dobët të themi financiarë të gjitha janë në humbje, kurse në anën tjetër kemi një pakënaqësi të madhe për performancën e tyre në terren apo në nivelin e shërbimeve dhe pakënaqësive të qytetarëve.

Mua thjesht më intereson a ka momentalisht apo është në hartim e sipër ndonjë strategji për përmirësimin e dy karakteristikave, njërës anë financiare, çështjes financiare në mënyrë që Qeveria mos të financojë këto ndërmarrje dhe në anën tjetër po ashtu ngritja e nivelit të shërbimeve për qytetarë. Faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Zharku! Nëse ka edhe dikush, zonja Kostiq!

BISERKA KOSTIĆ: Jedno od pitanja koja sam ja htela da postavim je predsednik već inicirao, a to je zastupljenost multietničnosti u javnim preduzećima.

Drugo pitanje, koje ja moram da iznesem zabrinutost svog naroda a to je, pošto znamo da je u sklopu javnog preduzeća da je pod jurisdikcijom i takozvana Kosovska Energetska Korporacija. Ne znam da li posedujete informaciju, ali ispravite me ako grešim. Mislim da su opština Gračanice i opština Štrpce, najredovnije platiše što se tiče električne energije. Međutim, zabrinutost naroda jeste da i pored toga, postoje već godinama redovne restrikcije u trajanju od 4 : 2, četiri sata ima, dva nema. Sela se dele po zonama, u zavisnosti od toga ko koliko plaća, jer ima u pojedinim predelima, u pojedinim delovima zapravo, sela postoji neko ko ne plaća struju i zbog nekih 20% onih koji ne izmire svoje dugove, celo selo nema struju. Mislim da to uopšte

nije u redu i ne znam koliko ste upoznati sa time i da li imate takvu vrstu informacija. To je jedno moje pitanje. Ustvari, zapravo izgovor KEK-a je stalno bio da se rade neke rekonstrukcije, medjutim te rekonstrukcije traju godinama vec.

Zatim moje drugo pitanje je, sto se tice vodovoda. Jeste da znamo da takodje Gračaničko jezero napaja vodom, snabdeva dosta veliki deo Kosova. Takodje u opštini Gračanici svakodnevno, naveče u 10,00 nestaje voda a dolazi tek u jutru u 5 u 6. Ne znam da li ste informisani oko toga. Ja znam da je potrebno određeno vreme da bi se voda filtrirala i da bi se ujutro pripremila da bude bakteriološki ispravna za upotrebu, ali to već godinama traje. Dali postoji bilo kakav... bilo kakvo rešenje ili plan za rešavanje ovog problema sa kojim se stanovnici opštine Gračanica svakodnevno susreću. Hvala!

HASHIM DESHISHKU: E kam një pyetje. Te sektori i ujit isha ndalë. Te Radoniqi, sidomos te... Gjakovë. Kush për shpenzimet operative të kostoja e stafit merr pjesë dikund 40%. Kurse, për te mirëmbajtja e sistemit është vetëm 1%. Financiar domethënë. Unë shtroj pyetjen: Si mund të ketë një furnizim të mirë kur mirëmbajtja merr pjesë vetëm 1%?

Dhe, pyetjen e dytë e kam te aeroporti. Para disa ditësh në gazeta ka qenë që disa kompani ajrore të mëdha do të largohen nga Kosova, për arsye se pronari i ri, unë e di që pronari i ri ka të drejtë me i rritë taksat, por a është e mundur që është bërë krahasimi me Maqedoninë dhe me Shqipërinë kur shkon taksa te na në disa sektorë është edhe përafërsisht 200% më e lartë se në Shqipëri ose në Maqedoni. Ka qenë një artikull në gazetë. Kaq për sot. Faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit shumë, zoti Deshishku! Nëse ka ndonjë pyetje tjetër nga ana e kolegëve deputetë? S'ka! OK! Atëherë zoti ministër e keni ju fjalën!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar! Do të tentoj të shkoj rend sipas pyetjeve të ngritura. Lidhur me gjetjet dhe rekomandimet që ne i kemi marrë. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, realisht bënë monitorimin e performancës së ndërmarrjeve publike për periudhën kur nuk ka qenë e autorizuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe monitoruese e tyre. Do të thotë pra, po flasim për një periudhë kur kemi pasur krejt një strukturë tjetër. Ne i kemi shikuar me kujdes të gjitha të gjeturat e auditorëve dhe tani Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike ka bërë një plan veprimi se si duhet të adresohen ato në të ardhmen, në mënyrë që shërbimet për qytetarët të jenë më të mira. Lidhur me strukturën e të punësuarve kemi informata të sakta nga 14.463 të punësuar, gjithsej në ndërmarrjet qendrore janë 13.972 shqiptarë, 491 janë të tjerë, nga të cilët 227 janë serbë dhe malazezë, 131 janë boshnjakë dhe myslimanë, 87 janë turq, 41 rom, ashkali dhe egjiptas dhe 2 të tjerë. Pra, kjo është struktura aktuale, të cilën ne e kemi.

Lidhur me kodin etik të ndërmarrjeve publike, njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike ka bërë një kod, draft kod i etik të cilin e ka dërguar te secila ndërmarrje. Dhe, ato realisht i kanë aprovuar këto kode të etikës dhe janë të thirrura për të vepruar konform këtij kod të etikës. Nëse flasim për ligjin për ndërmarrjet publike dhe amendamentimin të cilin zonja Selmani e ngriti, më lejoni të theksoj që ky ligj procedurat janë gati përfundimtare për të kaluar, pra, është një grup ndërministror pranë zyrës së kryeministrit, i cili është duke e trajtuar tash dhe harmonizuar me ligjet tjera. Në ligj kanë punuar asociacioni i komunave, ka punuar ICO-ja, kemi punuar ne si ministri dhe ministri të cilat kanë të bëjnë me shërbimet publike, që ne veprojmë. Po flasim edhe për Ministrinë e Pushtetit Lokal, por edhe Ministrinë e Ambientit dhe çështjeve të tilla. Pra, është një grup i njerëzve. Normalisht në çdo ligj ka edhe qëndrime të ndryshme. Ne ligjin jemi duke e bërë për të krijuar një funksionalitet dhe një ngjyrë, nëse mund ta quaj, të njëjtë të funksionimit të ndërmarrjeve në nivel lokal dhe në nivel qendror, përmes strukturave përafërsisht të njëjta, të cilat do të jenë të nivelit qendror dhe të nivelit lokal, por që, kur flasim

për politikën e fushëveprimit të tyre të kemi një linjë të qartë që udhëhiqet, do të thotë një strategji në nivelin qendrorë dhe në nivelin lokal. Dhe, kemi harmonizim të interesit të ndërmarrjeve publike me interesat e komunës. Pra, kjo është çështja thelbësore, të cilën ne jemi duke e trajtuar në komunat. Shumë raste kemi edhe kërkesa kur komunat kërkojnë pak më shumë kompetenca, por aty nganjëherë jemi edhe të shtrënguar, sepse nëse flasim për decentralizim total të ujërave, kjo nënkupton që do të jemi të shkapërderdhur në burime të resurseve kombëtare, që janë ujërat dhe realisht ne nuk kemi mundur ta adresojmë një çështje të tillë. Pra, ligji është në amendamentim. Shumë shpejtë do të kalojë në Qeveri. Dhe, pastaj do të sillet në Parlament ku të gjithë janë të mirëseardhur për të dhënë komentet e tyre për ta pasuruar një ligj, i cili do të na mundëson që ta kemi një mbikëqyrje por, edhe një funksionim shumë më të rregullt.

Nëse flasim për KEK-un dhe subvencionimet, e kemi vërejtur që në buxhetin e vitit të ardhshëm ne i kemi reduktuar në mënyrë të fuqishme subvencionimet për import. Duhet të kemi parasysh që KEK-u subvencionohet me dy linja. Një është linja për import dhe tjetra linjë është për rastet sociale. Për raste sociale edhe me tutje mbesin të njëjta. Është diku 4 milionë e gjysmë euro, ndërsa për vitin e ardhshëm janë paraparë 13.2 milionë euro subvencionim për import të energjisë elektrike, që në krahasim me vitin 2010 kanë qenë 27. Nëse e krahasojmë me vitin 2009, kanë qenë mbi 40 milionë. Pra, kemi një rënie të theksuar dhe kjo është për shkak të performancës dhe le të themi edhe reduktimit të shpenzimeve por, njëkohësisht edhe performancës më të mirë të inkasimit. Gjendja financiare e tyre, do të thotë është më mirë në këtë vështrim.

Tek ndarja e distribucionit, ne e kemi aprovuar konform rregullave të Unionit Evropian, ndarjen e KEK-ut në tri njësi. Është kuoti që merret me operim të sistemit dhe transmissiionit, është KEK-u që merret me gjenerim dhe distribucioni që do të merret me shpërndarjes se energjisë elektrike. Jemi në proces të privatizimit të Distribucionit. Kjo do të jetë ndërmarrje e veçantë, ku pastaj do të hapet edhe konkursi për të gjitha. Ju njoftoj që presim që shumë shpejtë të shpallim ftesën për ofertë për procesin e privatizimit të Distribucionit. Janë harmonizuar të gjitha dokumentet. Ne sot e kemi edhe një takim të radhës të Komitetit të privatizimit të Distribucionit, ku do të aprovojme dokumente finale, të cilat do të jenë pjesë e ftesës për ofertë. Prandaj, këtu është edhe roli i Rregullatorit. Roli i Rregullatorit në këtë koncept është që të rregullon tarifa dhe të siguron respektim të të drejtave të të gjithë konsumatorëve dhe që tani janë në diskutimin e definimit të tarifave për periudhën e ardhshme pesëvjeçare, që do të duhej të ishte deri në prill të vitit të ardhshëm. Njëkohësisht është bërë edhe dokumenti për metodologjinë e tarifave, dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm, i cili i ndihmon procesin e ndarjes së distribucionit. Ky dokument ka qenë në diskutim publik për një muaj. Fatkeqësisht, nuk kemi marrë sugjerime nga askush. Me insistim timin e kemi zgjatë edhe për dy javë diskutimin publik të këtij dokumenti. Ky dokument është përmbyllur duke marrë komentet nga KEK-u, KOST-i, Rregullatori dhe këshilltarët të gjithë që i kemi ne, do të thotë te transaksionet e këshilltarët e ndryshëm dhe realisht i ka paraqitur dhe ka dhënë këto refleksione. Është një dokument, i cili përcakton formula se si do të përcaktohen çmimet e energjisë në periudhën e ardhshme. Është përcaktuar edhe modeli i tregut. Dokument, i cili do të duhej të aprovohej shumë shpejtë, brenda këtyre ditëve. Ky model nënkupton, që në periudha të caktuara tregu duhet që realisht të liberalizohet, konform rregullave të Unionit Evropian. Pra, nuk flasim për monopol e ku ta di unë çka, edhe sot do të thotë ka mundësi të tilla. Këto janë standarde të Bashkimit Evropian, që ne i kemi marrë si obligim, përmes nënshkrimit të traktatit të energjisë dhe komunitetit të energjisë, ku edhe jemi pjesë e sekretariatit. Vlen të theksohet se ka pasur një lëvizje jashtëzakonisht të fuqishme në KOST, kur për shumë vite të tëra, Serbia e ka shfrytëzuar në mënyre legale territorin tonë për transmissiion. Ky proces është nisur në vitin 2010, ka kaluar nëpër të gjitha procedurat dhe tash kur ishim në konferencën e fundit në Vjenë, që kishim te ministrat e energjisë është konstatuar se: Serbia po shkel rregullat e Bashkimit Evropian dhe te Traktatit dhe që ia kanë dhënë 2 muaj ditë, pra 60 ditë pune ia kanë dhënë që t'i përmirëson. Nëse nuk i përmirëson, i pason ...

procedura tjera. Por, është me rëndësi që Traktati i energjisë dhe Sekretariati na identifikon si territor dhe KOST-in e njeh si operator të vetëm në Republikën e Kosovës si operator sistemi.

Tek PTK-ja. Privatizimi i PTK-së do të vazhdon. Ne jemi tani konform, le të themi të gjitha veprimet të cilat janë bërë më herët, tani jemi në proces të përgatitjes së procesit në tërësi, ndarjen e kemi marrë si vendim. Ndarja e obligon tani PTK-në, që ta fillon procedurën e ndarjes ligjore. Por, kjo thash që bëhet me regjistrim në një ndërmarrje të veçantë nga Qeveria, por ajo çka është shumë thelbësore është se tani kemi edhe procesin e aprovimit të planit të biznesit nga PTK-ja. Ky plan biznesi, realisht nënkupton aktivitetin njëvjeçar të PTK-së dhe që ne jemi duke e analizuar si aksionarë. Grupi i ministrave që merren edhe me privatizim, apo edhe grupi i ministrave që merret me ndërmarrje publike, pra, duhet të kalon nëpër dy njësi të tilla. Ne jemi të disponuar që, gjithsesi ti lëmë të gjitha ato investime që kanë karakter afatshkurtër të kthimit të investimeve. Jo, do të thotë të investimeve të cilat kanë karakter afatgjatë, sepse kjo nuk do të kishte interes për qytetarët e vendit, dhe që realisht ne do të vazhdojmë. Dëshiroj të ju them që Komisioni Qeveritar për Privatizim, ka marrë vendim për shkëputje të kontratës me TELKON, që ka qenë këshilltari i transaksionit dhe që realisht ne do të hapim një proces të ri shumë shpejt, besoj, për përzgjedhjen e një këshilltari të ri të transaksionit, i cili do të procedon me normat e reja, me kriteret e reja të cilat neve jemi në proces e sipër për të proceduar. Mendoj, që ka qenë vendim jashtëzakonisht i përgjegjshëm i Qeverisë, mos me hy me ba privatizim me çdo kusht, por, me e vërejt momentin kur tregu është më i volitshëm dhe kur ne, do të thotë, i ofrojmë diçka shumë më të pasur.

Tek aeroporti, mendoj që është çështje që duhet të trajtohet shumë më shumë në Ministrinë për partneritetin publiko-privat. Ne realisht kemi ndërmarrje publike. Kjo tashmë nuk e ka statusin e qartë të ndërmarrjes publike. Kjo është partneritet publiko-privat dhe këto janë çështje, të cilat e kalojnë kompetencën tonë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Lidhur me humbjet teknike, Berat kjo tregon që realisht ne kemi një nevojë shumë të madhe për investime kapitale dhe investimet kapitale janë zgjedhja e vetme në rrjet për t'i tejkaluar humbjet teknike. Flasim këtu tani dhe në këtë drejtim është obligim edhe i ndërmarrjes që do ta bënë privatizimin e distribucionit, që të bënë investime kapitale. Do ta shohim kur t'i ofrojnë ofertat, se çka ata ofrojnë për investime kapitale në humbje teknike. Por, humbjet teknike, do të thotë, deri në nivel të caktuar janë të pranueshme, sepse mund të ndodhin për secilin. Ajo çka ne jemi duke tentuar, është që të bëjmë reduktim të humbjeve komerciale me aktivitet shumë të përsheptuar, sepse këtu varet drejtpërsëdrejti nga menaxhimi, varet nga funksionimi i rendit të ligjit dhe nga funksionimi i gjyqësisë, sepse ka shumë lëndë, të cilat janë në gjykata, por që nuk janë zgjidhë dhe realisht kjo shkakton dëm për funksionimin e PTK-së. Lidhur me bordet dhe përgjegjësitë, më duhet të ju them që raportimet, të cilat ne i kemi marrë, te rasti i KEK-ut dhe i kemi disa raste, tregon që bordet kanë performuar konform interesave të aksionarit, por normalisht, performanca e cila është matë do të jetë element matës me përzgjedhjen e bordeve në të ardhmen. Kjo është arsyeja pse është bërë matja e performancës së bordeve. Bordet kanë proces të hapur të konkurrues, realisht në këtë drejtim ne do të vazhdojmë t'i trajtojmë.

Lidhur me ujërat dhe mbeturinat. Thamë që problemi i thelbësimit është jashtëzakonisht i madh. Një është për shkak të investimeve, të cilat problemet janë shumë të mëdha. Ne nganjëherë kemi edhe mos qartësi në investimet nëpër ndërmarrje, nëse flasim, të ndryshme, pra bëhen herë një investim, herë një tjetër, hapet një rrugë, prishet kanalizimi, toni vjen tjetri, do të thotë... dhe ne jemi duke tentuar që me ligjin e ri ta harmonizojmë që ndërmarrjet publike duhet të harmonizohen me orientimet strategjike të komunës, në mënyrë që të planifikohen investime të tilla. Por, sfida e jashtëzakonshme mbetet rregullimi dhe mbledhja e inkasimit. Kemi një rritje të inkasimit, e cila është e mirë dhe kjo ka qenë kërkesë e jona që ndërmarrjet mos të kënaqen me atë se kemi një performancë më të mirë në këtë vit për 2% kemi mbledhur më shumë se sa vitin

tjetër, sepse edhe më tutje mos inkasimi është ekstrem problem. Prandaj, në këtë drejtim prapë kërkohet një angazhim edhe i komunave. Ne problemin kryesor, po ju them, e kemi edhe te komunat, tek inkasimet, sepse kemi borxhlinj, të cilët janë ndërmarrjet apo le të themi komunale, institucionet komunale të cilat nuk i kanë kryer borxhet e veta dhe kjo e dëmton në mënyrë të drejtpërdrejtë performancën e ndërmarrjes publike dhe ne kemi kërkuar, që komunat ta trajtojnë, sepse komunat janë përfitues të buxhetit përmes grantit qeveritar edhe për këto ndërmarrje. Pra, nuk kanë arsye të mos e bëjnë pagesën dhe të vijnë në situata kur, realisht kemi situata të... që nuk rreth pagesave.

Lidhur me pyetjen e zonjës Kostić, te përfaqësimi, e theksova. Tek furnizimi me rrymë. Ne në Ministri nuk merremi me çështje të operativës së përditshme, por ju kemi dhënë obligim dhe obligim ka edhe KEK-u edhe KOST-i dhe të gjithë, që t'i respektojnë të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe kjo është politikë të cilën ne e udhëheqim dhe do ta mbajmë përgjegjës secilin, i cili nuk e respekton këtë, apo bënë shkelje të kësaj qasjeje.

Edhe lidhur me ujësjellësin... do të thotë, nuk është problem unik. Atje është problem për të cilin unë fola dhe është problem për të gjitha komunat. Pra, është një çështje që duhet të trajtohet ... Tek Radoniqi, sigurisht që problemi i inkasimit dhe prapë vjen tek kapitali, sepse punëtorët, të cilët janë në mënyrë të drejtpërdrejtë të angazhuar ata kryejnë, ndërsa pjesa tjetër e mjeteve financiare mbetet pak e vogël për të bërë investime kapitale. Kjo është arsye pse ne, kur i kam vizituar një numër të madh të ujësjellësve iu kam thënë, që nuk duhet asnjëherë të kënaqeni me atë se keni 1% apo 2% performancë më të mirë. Performanca duhet me ardhë deri në nivelin, kur ata me inkasimet e veta bëjnë edhe investimet kapitale, të cilat iu ofrojnë atyre shërbime, në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Ndërsa për taksën e aeroportit, nuk jam kompetent, nuk jam kompetent dhe nuk mund të flas për të. Faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, ministër!

Ndërkohë që si pjesë e këtij raporti del se, auditimi i jashtëm nga pjesa ku është prezantuar del pozitiv. Nga 15 ndërmarrjet qendrore të auditimit, 7 nga ato kanë vlerësimin më të lartë nga auditori i jashtëm, të vlerësuara si të pakualifikuara, ndërsa 7 tjera si të kualifikuara me theksim çështje, dhe një me opinion të kundërt. Pra, kryesisht del opinion pozitiv.

Në ndërkohë që organizata të ndryshme kanë, e kemi konkret një raport të KIPRED dhe GAP, që auditon funksionimin e bordeve të ndërmarrjeve publike. Ka një raport, i cili është mjaft interesant dhe ne na ka ndihmuar, në njëfarë mënyre edhe si deputetë, besoj që edhe juve si institucion me e pa edhe më mirë funksionimin nga një kënd tjetër, nga një monitorim i një pjese tjetër. Nga ajo që tha zoti ministër sidomos, ju prezantuat freskimin ose riorganizimin e bordeve, konkurset e reja, unë i kam parë edhe disa kritere që ju i keni nxjerrë atje. Kryesisht bazohen edhe nga disa gjetja, të cilat unë personalisht e kam lexuar edhe raportin e KIPRED&GAP.

Unë dëshiroj t'i jap fjalën përfaqësuesit të GAP, zotit Demi.

AGRON DEMI: Në fund të 2008-ës, nëse më kujtohet mirë, nëntor apo dhjetor është bërë përzgjedhja e shumicës së anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike, ku pastaj ka intervenuar me presion politik ICO dhe është dashur që në prill të vitit 2009, pastaj me i zëvendësuar disa anëtarë të bordeve apo me ua ndërruar vendet, për shkak se ICO ka konsideruar se shumica e bordeve të përzgjedhura në fund të vitit 2008 ka qenë përbërje politike.

Duke u lidhë me raportin, që është prezantuar, ne si shoqëri civile e kemi mirëpritur këtë raport, për shkak se gjer më tani nuk ka ekzistuar një raport i tillë. Shumicën e kohës organizatat dhe shoqëritë civile nuk kanë pasur qasje të duhur në performancën e ndërmarrjeve publike. Megjithatë, mbetet për me u plotësuar raportet e viteve tjera. Në faqen 3 të këtij raporti thuhet se, performanca teknike dhe çështjet më të detajuara për performancën e ndërmarrjeve publike mund të gjenden në raportet individuale dhe në ueb-faqet e këtyre kompanive. Mirëpo, ne kemi shikuar, shumica e ndërmarrjeve qendrore nuk i kanë të publikuara raportet e tyre vjetore, apo nuk kanë të përditësuara informatat që i publikojnë në ueb-faqet e tyre zyrtare. Po ndalem pak më shumë te PTK. Ministri e arsyetoi rënien e fitimit me interesin për dividendën, mirëpo prej raportit të PTK-së del se nuk është vetëm kjo arsyeja. Prej vitit 2009 në vitin 2010, ka pasur një rritje të punësimit në PTK, e cila pastaj edhe e ka ulur vlerën e fitimit, apo siç përmendet në raport faqe 26, janë punësuar 152 vetë, ku shpenzimet janë rritur për 7 milionë. Në anën tjetër në këtë kohë ka qenë PTK në proces të privatizimit dhe shumica e projekteve kapitale të PTK-së janë ngrirë derisa të vendoset për fatin e PTK-së. Është shqetësuese rreth asaj se shumica e, siç u përmend edhe nga deputetët, shumica e ndërmarrjeve publike operojnë me humbje dhe është shqetësuese, se pothuajse në të gjitha ndërmarrjet qendrore dhe lokale, përjashtoj tri ndërmarrje publike, është ngritë niveli i punësimit, përderisa ka rënë niveli i faturimit, e cila duhet të zgjidhet me anëtarë të ri të bordit, që të jenë më profesional dhe të ofrojnë plane konkrete se si do ta ngjallin kompaninë, kur ata synojnë të jenë pjesë e bordit, për shkak se bordi dhe Qeveria si aksionare, është përgjegjëse për humbjet që po shkaktohen në këto kompani.

Për fund, u përmend ndarja e hekurudhave. Besoj, nuk jam shumë i familjarizuar me draftligjin për ndërmarrje publike, i cili është në proces të ndryshimit, por ndarja e hekurudhave duhet të përfshihet me siguri edhe në ligjin e ri për ndërmarrje publike, me qëllim që të jetë me ligj kjo ndarje. Siç e thash, ne e kemi mirëpritur këtë raport, duke pasur kohë me e lexuar edhe me e komentuar në detaje, por me siguri në vazhdim do të dalim me një raport se çka do të duhej të kishte një raport i tillë, me qëllim që të jetë më informues edhe për deputetët edhe për publikun, do të thotë do, të bashkëpunojmë ngushtë me njësitin për ndërmarrje publike. Faleminderit shumë!

BESIM BEQAJ: Kryetar, ne me të vërtetë mirëpresim çdo sugjerim nga ... kushdoqoftë... më të drejtpërdrejtë, por njëkohësisht inkurajoj edhe shoqëritë civile, që shënimet të cilat merren për vlerësime le të merren në institucionet gjegjëse, të mos merren në bazë të perceptimeve të ndryshme, apo në bazë të vlerësimeve individuale, që mund të jenë edhe të gabuara. Njësia për monitorim të ndërmarrjeve publike do të jetë në dispozicionin tuaj për të ofruar të gjitha dokumentet publike. Po bëjë edhe një herë një pyetje thotë “konform në draftdokumente”, sigurisht që ju duhet ta keni mirëkuptimin se këto janë dokumente, të cilat janë në punë e sipër, por të gjitha dokumentet publike, të cilat kanë obligim ndërmarrjet publike dhe që ka, ne do të ju japim. Prandaj, në bazë të këtyre ne e mirëpresim çdo raport, çdo sugjerim nga ana e juaj. Sa i përket rasteve të konfliktit të interesit, që iu referove, Ministria për Politikë dhe Monitorim, i ka proceduar rastet në Agjencionin për antikorrupsion, aty ku ka pasur bazë. Dhe, kjo është kompetenca jonë, do të thotë ne deri këtu ... na përfundon aktiviteti ynë. Prandaj, kemi raste të cilat janë proceduar dhe presim zgjedhjen nga ana e tyre.

Prandaj, edhe lidhur me performancën e PTK-së, dëshiroj të theksoj se vendimi për ndalimin e punësimit është në maj të vitit 2010 dhe që ne flasim për punësime, të cilat janë paraprakisht. Ne nuk kemi asnjë të dhënë, që pas vendimit të Qeverisë për ndalimin e punësimit, që kemi të punësuar të tjerë. Prandaj, të jemi vetëm korrekt në informacionet të cilat i japim nga 2009-ta në 2010 ka pasur diku mbi 150 punëtorë të punësuar, që konform veprimeve, të cilat janë treguar dhe konform raportimeve nga ana e PTK-së kjo ka qenë arsyeshmëri ekonomike dhe funksionale dhe ne, normalisht çdo ndërmarrje e cila duhet të rritet, duhet edhe të presim punësime të reja. Kjo është e natyrshme dhe do të ishim shumë të lumtur që ndërmarrjet të rriten dhe të punësojnë

njerëz të rregullt, do të thotë në një mënyrë, por po e them që së paku nga momenti kur ne, kur është marrë Vendimi i Qeverisë, unë nuk kam informacion dhe nëse dikush ka një informacion të tillë, sigurisht se do të ishte mirë që të raportohet. Ato mund të kenë edhe organizime të brendshme, por punësime të reja, nuk kam informacion që ka pasur. Prandaj, unë dua të them që është bërë shumë, është bërë shumë zhurmë për PTK-në për humbjen e vlerës së PTK-së dhe mendoj, që informacionet të cilat janë jo të sakta, informacionet të cilat janë në bazë të le të themi, orientimeve momentale, sigurisht janë kontribut i drejtpërdrejtë. PTK-ja nuk ka pasur humbje sikur po pretendohet me thënë që PTK-ja humbi nga 44 milionë e 33 milionë e ... ku ta di unë çka. PTK-ja ka pasur performim më të mirë. PTK-së iu kanë hjekë 11.2 milionë, vetëm nga interesi. PTK i ka ulë këto shërbime, çmimin e shërbimeve për qytetarët e vet, prandaj ne k... konsumatorët e vet më mirë me thënë. Dhe, në këtë drejtim ne kemi një performancë e cila edhe më tutje është .. do me thënë që nëse krahasohet tash me mosinkasimin nga interesi dhe nga ulja dhe është performancë më e mirë. Absolutisht është performancë më e mirë. Dhe, kjo duhet të thuhet, sepse jemi në një proces, i cili nëse neve themi ndryshe, ne realisht po ia ulim përmes deklarimeve të tilla, po i ulim vlerën edhe të transaksionit. Këto janë fakte dhe realitete. A ka gjëra që mund të përmirësohen? Sigurisht që ka shumë gjëra që mund të përmirësohen. Ne shpresojmë që edhe bordi i ardhshëm edhe funksionimi, do të thotë sepse edhe anëtarëve tjerë do t'iu del kjo, do të jenë shumë më kompetentë në drejtimin e asaj që të reduktohen shpenzimet edhe më tutje, sepse ka hapësirë edhe më tutje për t'u reduktuar shpenzimet dhe ne i kemi inkurajuar bordin, që në planin e biznesit të tyre të vijnë ata me propozime. Të mos marrim ne çfarëdo veprimesh, sepse nuk jemi ne ata të cilët duhet me marrë veprime tilla. Për planin e biznesit përgjegjës janë bordet, për operim janë drejtorët ekzekutiv, për mosoperim të mirëfilltë operacional, përgjigjet drejtori ekzekutiv para bordit. Bordi për mospërçarje të interesit të aksionarit, përgjigjet para aksionarit. Këto janë linja e përgjegjësisë në ndërmarrjet publike. Faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti ministër! Është më duket pyetja e fundit, Zoti Damka!

FIKRIM DAMKA: e kini përgjigj, por nuk kam marrë unë tamam përgjigjen për këto pyetje. A e kini naj plan të veprimit rreth përmirësimit të situatës së gjendjes, pjesëmarrjen jo shumicës në ndërmarrjet publike, sepse sipas planit të Ahtisarit, është 10% pjesëmarrja e joshumicës, serbë, boshnjakë, turq dhe të tjerë, në ndërmarrje publike. Po, sipas statistikave unë që i kam në dorë prej anës së ministrisë së juve, është afër 470 dikund, e cila është vetëm 3%. Një 7% po mungon. A i keni naj plan veprimit, qysh të përmirësoni këtë gjendje.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti Damka!

BESIM BEQAJ: Ne, në ndërkohë është marrë një vendim për ndalimin e punësimit nëpër të gjitha këto ndërmarrje, është element që ka marrë një vendim Qeveria, të tillë dhe ka një politikë të tillë. Sigurisht që në punësime të reja, ne i inkurajojmë të gjitha ndërmarrjet, që të punësojnë sa më shumë njerëz, konform planeve të caktuara, por gjithmonë duke respektuar parimin e profesionalizmit për punësimet në ndërmarrje publike.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit! Zonja Selmani, thatë shkurt... apo?

MYZEJENE SELMANI: Po, jo shumë shkurtë do të jetë! Kryetar, faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: ... edhe zoti Kelmendi!

MYZEJENE SELMANI: Do të doja, ministri edhe një herë, në mënyrë shumë kolegiale, që mbas gjithë procesit që do të ... në ... ju kisha lut që së paku të na... së paku në çështjen e modelit të tretë. Se është shumë me rëndësi për çështje të kostos së tarifave.

ZENUN PAJAZITI: Zoti ministër, edhe një ... zoti Kelmendi e pati edhe një pyetje...

MYZEJENE SELMANI: Më fal, qe kjo ishte kërkesa!

RAMIZ KELMENDI: Unë dëgjova që ndarja e Valës prej Postës, po bjen që objektet do të jenë të Postës, a pajisjet do të jenë të Valës. A e zvogëlon kjo interesin e investitorëve të huaj. A e zvogëlon performancën, për arsye se kemi të bëjmë me një qiraxhi të imponuar dhe të gjitha mospajtimet e punëtorëve që do të ndodhin, do të kenë mundësi që t'i bllokojnë dyert e blerësit të ri.

BESIM BEQAJ: Deputet, është shumë e qartë ndarja kontabël, ... pajisjet i kanë të veçanta nga pajisjet, të cilat merren me PTK-në. Unë po flas për asetet fizike, të cilat nuk kanë të bëjnë me biznesin e Telekom-it dhe të Valës. Kjo është një. E dyta, kur është bërë ndarja kontabël, është përcaktuar edhe lista e punëtorëve, po flasim për listë të fiksuar të njerëzve, të cilët janë. Ne këtu nuk presim, sepse kjo ndarje nuk është bërë nga ministria. Kjo ndarje është bërë nga PTK-ja vetë, do të thotë, konform gjendjes të cilën e ka brenda për brenda. Ndërsa, sa i përket dokumentave, unë do të jem i gatshëm në çdo kohë kur ftohem nga Komisioni Parlamentar, për të diskutuar nën pikë të veçantë, sa i përket privatizimit të Distribucionit, edhe për të diskutu edhe dokumentet tjera. Kemi hyrë në fazën finale të përgatitjes së saj dhe, të gjithë ata që dëshirojnë të dinë në mënyrë individuale, mund të vinë në ministri, të takojnë edhe njësinë, por nëse ka interes edhe për tërë grupin, unë jam i gatshëm në çdo kohë, që t'ju informoj. Faleminderit!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit shumë! Zoti ministër, edhe njëherë ju falënderoj shumë për pjesëmarrjen dhe prezantimin e këtij raporti! Ne formalisht duhet të jemi edhe pak minuta, sepse ne duhet ta qesim në miratim, në votim brenda komisionit, këtë raport. Pasi që ministrin ta kemi liruar. Zoti ministër, ju falënderojmë edhe një herë shumë edhe për bashkëpunimin në përgjithësi. Ne do të vazhdojmë edhe pak me punë.

BESIM BEQAJ: Mirupafshim! Faleminderit! Ditën e mirë.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, shume! OK, nëse ka edhe dikush ndonjë... diçka... Ne sipas procedurës, meqenëse gati e shterëm debatin. Unë e kisha qitë në votim. Sipas rregullit, më duket kjo shkon pastaj në seancën e radhës të Kuvendit. OK, kush është "Për"? Ok, faleminderit "Kundër"? S'ka! Miratohet Raporti. Atëherë kalojmë në pikën tjetër, të ndryshme.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve